

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Vënia në zbatim e reformës së KSP-së në Shqipëri (përfitimet dhe sfidat)

zj. Erisa Rodhani
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Kontabiliteti publik në Shqipëri

- Kontabiliteti publik në Shqipëri mbështetet aktualisht në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore të Njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.
- Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Auditimit është përgjegjëse për hartimin e metodikës dhe rregullave të kontabilitetit publik.
- Projekti shumëfazësh për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit në sektorin publik shqiptar ka filluar në 2018.

Analiza e hendekut për kontabilitetin e sektorit publik

- Mungesë përcaktimi preciz të numrit të njësive të kontrolluara të sektorit publik;
- Kuadri ligjor për kontabilitetin dhe raportimin në sektorin publik ishte kompleks, i fragmentuar dhe i paqartë;
- Mungesë arsimit dhe formimit profesional në fushën e financave dhe kontabilitetit të sektorit publik;
- Mungesë kodi etik për kontabilistët e sektorit publik;
- Sistem buxhetor i ngatërruar;
- Funkcionim i pjesshëm i sistemit SIFQ, pavarësisht se përdoret në shumicën e sektorit publik;
- Mungesë e një regjistri të konsoliduar aktivesh për njësitë e qeverisjes së përgjithshme në Shqipëri (mungesë e një metode të caktuar për matjen dhe inventarizimin e aktiveve).

Objektivat e reformës së kontabilitetit të sektorit publik

Qeveria e Shqipërisë është angazhuar për zbatimin gradual të një sistemi modern të kontabilitetit të sektorit publik bazuar në standardet ndërkombëtare.

Qëllimi kryesor i këtij angazhimi është arritja e dy objektivave kryesorë:

- Zhvillimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të sektorit publik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP);
- Zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale në fushën e kontabilitetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për kontabilistët e sektorit publik.

Përfitimet e vënies në zbatim të SNKSP-ve në Shqipëri

- Më shumë transparencë dhe llogaridhënie në vendimet e marra nga juridiksionet për donatorët, qytetarët dhe investitorët;
- Informim i plotë për të ndihmuar një vendimmarrje më të mirë;
- Një inventar i plotë i aktiveve dhe inventarëve, çka u jep mundësi njësive ekonomike të vlerësojnë nëse këto po përdoren në mënyrë efektive dhe ekonomike në funksion të realizimit të shërbimeve publike;
- Një kuadër raportues i njohur në nivel ndërkombëtar është një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e stabilitetit financiar të vendit dhe aftësisë për të thithur investime duke mbështetur vlerësime kreditore më të drejta dhe më të sakta dhe duke nxitur investimet e huaja të drejtpërdrejta;
- Qeverisja e financave publike do të përmirësohet nëpërmjet rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, të cilat kërkohen nga dhënia e informacioneve për aktivet dhe në veçanti detyrimet e qeverisë.

Qasja e Shqipërisë për vënien në zbatim të SNKSP-ve

Kontabiliteti publik në Shqipëri aktualisht mbahet mbi bazë monetare me elemente të kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për sa u përket aktiveve dhe detyrimeve.


Futje e pjesshme në zbatim e SNKSP-ve: PPPK kombëtare të sektorit publik modifikohen dhe/ose PPPK të reja të sektorit publik publikohen në përputhje me pjesë të përzgjedhura të SNKSP-ve të përzgjedhura.

Ka shumë arsye përse kjo është qasja e preferuar, ndër të tjera:

1. Ka një listë përputhshmërisht dhe mospërputhshmërisht mes PPPK të sektorit publik shqiptar dhe SNKSP-ve për çdo standard. Gjithashtu, ***jo të gjithë SNKSP-të lidhen*** me kushtet e Shqipërisë dhe jo të gjitha pjesët e një standardi janë të zbatueshme në kushtet e Shqipërisë.
2. Qasja e tanishme u siguron kontabilistëve parime konkrete, specifike dhe të qarta kontabël për të siguruar kuptim të qartë të kërkesave dhe për të shmangur çdo mospërputhshmëri në zbatimin e standardeve të kontabilitetit. ***Disa prej SNKSP-ve origjinale nuk janë të harmonizuara me qasjen lokale të vendit*** dhe pritjet kulturore lidhur me rastet kontabël.

Qasja për afatet

ALBANIA IPSAS IMPLEMENTATION - SUCCESSIVE STEPS PRIORITISATION OF THE IMPLEMENTATION APPROACH



Veprimtari të ngritjes së kapaciteteve

- ✓ Program trajnim i trajnuesve mbi raportimin financiar dhe kontabilitetin në sektorin publik mbështetur në SNKSP **(28 pjesëmarrës)**.
- ✓ Pilotim trajnimit për herë të parë të personelit të financës dhe kontabilitetit në institucionet e pushtetit qendror mbi kontabilitetin dhe raportimin financiar në sektorin publik mbështetur në SNKSP **(100 kontabilistë nga rreth 20 institucione të ndryshme)**.

Veprimtari të ngritjes së kapaciteteve

- ✓ Hartohet një program i ZHPV-së
- ✓ Hartohet një kornizë arsimore për zhvillimin profesionalistëve kontabël të sektorit publik

Sfidat

Sfidat politike/drejtuese

- ✓ Reforma e kontabilitetit/reforma e menaxhimit të aktiveve nuk shihet me të njëjtin interes politik si buxheti, tatim-taksat, borxhi, prokurimet etj.;
- ✓ Përfshirje aktive e drejtimit të lartë;
- ✓ Ndryshime në panoramën politike dhe ndryshim i drejtimit të lartë.

Sfida strukturore/organizative

- ✓ Sfida të mëdha në motivimin dhe menaxhimin e palëve të interesit;
- ✓ Rezistencë nga palët e interesit ngaqë kjo kërkon prej tyre ndryshime.

Sfida në kapacitete

- ✓ Ngritja e aftësive në ekspertizë;
- ✓ Mungesë e informacioneve teknike të nevojshme dhe mungesë e kapaciteteve profesionale;
- ✓ Rritja e kapaciteteve të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për të zhvilluar metodika kontabël, për të përkthyer SNKSP-të dhe për të bërë zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Kapërcimi i sfidave dhe pengesave të hasura

Politike / drejtuese / organizative

- ✓ Përgatitja e një strategjie për menaxhimin e ndryshimit;
- ✓ Komunikim dhe angazhim i vazhdueshëm, me rëndësi jetike për këtë proces;
- ✓ Ndërgjegjësim me udhëheqjen e MFE-së;
- ✓ Ngritja e një komiteti drejtues dhe strukturave të menaxhimit të projektit;
- ✓ Angazhim dhe komunikimi me palët e interesit;
- ✓ Pjesëmarrës të rëndësishëm të palëve të interesit dhe përfituesve në komitetin drejtues;
Gjithashtu, kanë marrë pjesë edhe në aktivitete të projektit.

Kapaciteti / njerëzit


- ✓ Aktivitetet e para lidheshin me rritjen e kapaciteteve brenda ekipit të zbatimit të projektit, me Bankën Botërore, ACCA (SNKSP, SNRF, MFP), CIPFA (përpara këtij projekti);
- ✓ Ngritja e një ekipi që kishte niesën më të madhe të kapacitetit

Kapërcimi i sfidave dhe pengesave të hasura

Partnerët e jashtëm

- ✓ Mbështetja e partnerëve të jashtëm / donatorëve është përdorur si faktor shtytës në nivel politik/drejtues dhe për ndërgjegjësim;
- ✓ Informim, angazhim me Bankën Botërore për mbështetje. Një drejtues i lartë kyç duhet të ngulë këmbë dhe të angazhohet për të punuar me ta nga afër;
- ✓ Përfshirje në Komitetin Drejtues dhe aktivitetet e Projektit;
- ✓ Komunikim aktiv, formal dhe joformal;
- ✓ Një dokument i dobishëm ishte strategjia për komunikimin.

Përputhja me nismat e tjera




Rezultatet e pritura

- Paraqitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNKSP-të e përzgjedhura.
- Rritja e cilësisë së kontabilitetit, statistikave dhe raportimit financiar
- Përmirësimi i kapacitetit teknik të Njësisë së Raportimit Financiar pranë MFE-së (të cilit i është ngarkuar detyra e vënies në zbatim të rregullave të kontabilitetit publik) dhe Njësisë Qendrore të Harmonizimit (përgjegjëse për metodikën e kontabilitetit publik) në përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Zhvillimi i një kualifikimi të qëndrueshëm të kontabilitetit të sektorit publik në përputhshmëri me praktikat e mira ndërkombëtare; dhe përmirësim i njohurive për standardet përkatëse të kontabilitetit dhe i zbatimit të tyre nga ushtruesit e profesionit.
- Rritje ndërgjegjësimit për përfitimet që sjell përmirësimi i kontabilitetit dhe raportimit në sektorin publik te palët e interesit (qeveritarë, politikanë, media dhe organizata të shoqërisë civile).

Grupet e interesit të projektit

Palët kryesore të interesit të projektit janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përdoruesit me prioritet të fondeve publike, INSTAT dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.



FALEMINDERIT!

